



## Njoftim për shtyp

### Alpha Bank Albania mbështet Panairin dhe Konkursin Kombëtar të Shoqërive të Nxënësve

Më 04 maj 2016, në mjediset e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u mbajt Panairi dhe Konkursi Kombëtar i Shoqërive të Nxënësve, organizuar nga Junior Achievement.

Në këtë panair, morën pjesë 23 shoqëri sipërmarrëse të përfaqësuar nga ekipet drejtuese të nxënësve. 138 nxënës maturantë nga gjithë vendi ndërvepruan me vizitorët e panairit, duke promovuar idetë e tyre, duke shpalosur talentin dhe shpirtin sipërmarrës si dhe duke prezantuar produktet apo shërbimet që kanë arritur të realizojnë në kuadër të këtij eventi.

Në fjalën e tij përshëndetëse, z. Orfea Dhuci, Këshilltar Ekonomik i Alpha Bank Albania theksoi mbështetjen e vazhdueshme që Alpha Bank Albania ka dhënë për iniciativa të tilla, që synojnë të promovojnë aftësitë e të rinjve dhe që shërbejnë njëkohësisht si një katalizator shumë i mirë për të orientuar të rinjtë drejt modeleve dhe sfidave të sipërmarrjes së lirë.

“Secili prej jush këtu, është padyshim, një shembull suksesi që duhet të shtrihet përtej këtyre ekspozitave dhe të jetë shembull në komunitet, në shkolla, për t’u përjetuar nga shumë të rinj të tjerë.

Njëkohësisht, ju keni marrë përsipër edhe përgjegjësinë që të jeni një model, që të mbartni përsipër riskun e një sipërmarrjeje të re si dhe që të tregoni se zhvillimi vjen nëpërmjet inovacionit – siç janë edhe idetë që ju keni paraqitur” theksoi z. Dhuci.

Alpha Bank Albania është pjesë e Grupit Alpha Bank, themeluar që prej vitit 1879 dhe është një nga bankat dhe grupet financiare kryesore në Greqi, duke i ofruar një gamë të gjerë shërbimesh, individëve, SME-ve, korporatave, nëpërmjet kartave të kreditit, drejtimit të aktiveve, veprimtarive bankare të investimit, veprimtarive bankare vetjake, veprimtarive të ndërmjetësit, leasing dhe factoring, etj. Alpha Bank është gjithashtu aktive në tregun ndërkombëtar bankar, me prani në Qipro, Rumani, Bullgari, Serbi, Shqipëri, Maqedoni dhe Mbretërinë e Bashkuar.

